

Titulli i lëndës: GJUHË TURKE 4

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë - Dega e Orientalistikës
Titulli i lëndës:	Gjuhë Turke 4
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Lënda zgjedhore
Viti i studimeve:	III
Numri i orëve në javë:	1+2
Kreditë ECTS:	5
Koha / Vendi:	Prishtinë
Mësimdhënësi:	Prof.ass.dr. Zeqije Xhafçe
Të dhënat kontaktuese:	Zeqije.xhafqe@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	<p>Kjo lëndë është vazhdimi i Gjuhës Turke 3 (niveli i kursit B1), e cila përmban tema të tjera të jetës së përditshme që trajtohen në një nivel më të lartë të të folurit. Duke mësuar tema të reja gramatikore ndërtohen fjalitë të zgjeruara. Mësohet përdorimi i diatezës shkakore dhe reciproke, si dhe diatezës së kombinuar, sipjesoret me <i>-ecek</i> dhe me <i>-dik</i> dhe kombinimet e tyre me parafjalët dhe mbaresat rasore. Përmbanë tema të lidhura me trendet, modën, mitologjinë, edukim dhe arsim, artet të ndryshme (pikturë, kinematografi, muzikë, letërsi etj.) dhe krijimtari, shkencët dhe zbulimet, diversitetet njerëzore etj.</p>

Qëllimet e lëndës:	<ul style="list-style-type: none"> - të komunikojnë lirshëm në gjuhën turke në një nivel më të lartë, - të përsosin aftësinë e të dëgjuarit, përmes mjeteve auditive dhe kolegëve të tyre, -të nxjerrin konkludime, gjykime dhe vlerësime nga tekstet e shkruara në gjuhën turke - të zotërojnë edhe më shumë aftësitë e të folurit në situatat të ndryshme, - të zgjerojnë fjalorin dhe shkathtësitë e të shkruarit në gjuhën turke.
--------------------	--

Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti :
	<ul style="list-style-type: none"> - Definon fjalë dhe koncepte të reja në fushën e edukimit, estetikës, artit, letërsisë dhe teknologjisë. Njih dhe zbaton kategori të reja gramatikore (format e pashtjelluara e foljeve, pasfjalët, mënyrën kushtore, diatezën shkakore dhe diatezën e shumëfishtë etj.)
	<ul style="list-style-type: none"> - Përmbledh dhe përshkruan ngjarje dhe aktivitete të ndryshme kulturore në ambiente të ndryshme p.sh. ekspozitë, qendër tregtare, muze, institucione të arsimit.
	<ul style="list-style-type: none"> - Shkruan tekste (ese) me tema të thjeshta në lidhje me aktivitetet kulturore.
	<ul style="list-style-type: none"> - Dallon dhe krahason kulturën dhe botën e tij me kulturën botërore dhe në veçanti me atë turke
	<ul style="list-style-type: none"> - Vlerëson dhe gjykon ngjarje dhe situata përmes zgjedhjeve gjuhësore të reja. Diskuton me studentët e tjerë, shpreh mendim personal dhe kritik.
	<ul style="list-style-type: none"> - Mëson terminologji të reja
Ngarkesa studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)	<ul style="list-style-type: none"> - njih dhe zbaton kategori të reja gramatikore (format e pashtjelluara e foljeve, pasfjalët, mënyrën kushtore, diatezën shkakore dhe diatezën e shumëfishtë etj.)

Ngarkesa studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej

Ligjëratat	1 (45 min)	15	15
Teori/Punë në laborator/Ushtrime	2 (90 min)	15	30
Punë praktike	20 min	15	5
Përgatitje për test intermediar	30 min	2	1
Konsultime me mësimdhënësin	20 min	15	3
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit	2	3	6
Detyrë shtëpie	1	5	5
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2 (90 min)	15	30
Përgatitja për provimin final	3	7	21
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	3	2	6
Projektet, prezantimet, etj.	1	1	1
			123 orë 123/25= 4,92 ECTS

Metodat e mësimdhënies:

Gjuhë Turke IV është mësim i rregullt dhe mësimi mbahet në mënyrë grupore dhe 1+2 orë në javë. Forma e ligjerimit është praktike dhe interaktive. Pjesa teorike përbënë 25% ndërsa pjesa praktike 75% të lëndës. Organizohen vizitat në qendrat kulturore turke, merret pjesë në seminare të ndryshme letrare, gjuhësore etj.

Metodat e zbatuara gjatë ligjeratës janë:

- Metoda e garmatikës-përkthimit,
- metoda direkte e cila bazohet në dialogje ose tregime të shkurtra me të cilët tërhiqet interesi i studenteve dhe e cila bazohet në dëgjim, lexim, kuptim dhe bised,
- metoda e bazuar në detyra,
- metoda audio-linguale,
- metoda audiovisuale,
- metoda komunikative dhe eklektike.

Metodat e vlerësimit:

Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 60%.
Vijueshmëria e studentit 10%;
Kollokviumi 30%
Provimi final 60%.

Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Yeni İklim Türkçe B1 Ders Kitabı, Yunus Emre Enstitüsü Türkçe Öğretim Seti , z- kitap 2. Korkmaz, Zeynep, Türkiye Türkçesi Grameri, Türk Dil Kurumu Yayınları, Ankara, 2009 3.G.L.Lewis, Turkish Grammar, 1967, Second edition 2000. Oxford: Oxford University Press 4. Mehdi Polisi, Gramatika e Gjuhës Turke, Logos, Prishtinë, 2002
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Jaklin Kornfilt, Turkish Grammar (Descriptive Grammar), Routledge, London, 1997 2. Veprat klasike dhe bashkëkohore letrare turke

Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	<i>E sotmja dhe e djeshmja e modes</i> Pafjalët: -den beri/-dir
Java 2:	<i>Ç'është në vitrin?</i> Pafjalët: -dik + p.pronësore+ (n)dEn beri
Java 3:	<i>Ky është stili im</i> Forma e pashtjelluar e foljes: -(di) ... -(y)eli
Java 4:	<i>Edukimi është kusht</i> Mënyra Kushtore: p. e kohës + -(y)se (ise)
Java 5:	<i>Kurrë nuk është vonë</i> Fjalitë emërore në mënyrën kushtore
Java 6:	<i>Të mësuarit nuk ka kufi</i> Mënyra kushtore në kohën e kryer -se(y)di (-se idi)
Java 7:	Kolokvium
Java 8:	<i>Estetika dhe Krijimtaria</i> Diateza shkakore : -(i)t-/Dir-/Er-Ir-
Java 9:	<i>Arti është jetë</i> Pasurimi i fjalorit <i>Biseda rreth artit në Kosovë</i>
Java 10:	<i>Prezantimi i arteve të ndryshme të pazakonshme: arti i zallit etj.</i> <i>Stambolli nga zalli</i> Diateza e shumëfishtë: -(i)t-/dir-/er-/ir- + -t-/tir-
Java 11:	<i>Ç'farë po ndodh në skenë?</i> Diateza reciproke + diateza shkakore -(i)s- +tir-

Java 12:	<i>Shpikjet dhe shpikësit</i> Diateza pësore –il-
Java 13:	<i>Interneti dhe zbulimet e tjera</i> Ndërtimi dhe përdorimi i grupit të fjalëve: <i>tarafindan/-ce</i>
Java 14:	<i>Projektet e nervit të intelektit</i> <i>Kombinimi i diatezave reciproke + shkakore + pësore –(i)ş- /-tir-/-il-</i>
Java 15:	Kolokvium

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Për të pasur sukses më të mirë dhe më të lehtë në përvetësimin e lëndës janë disa kërkesa që duhet t'u përmbahet studentit. Të gjitha ato mund të përfshihen shkurt: vijimi i rregullt i mësimit; interesimi dhe angazhimi i tij për ta përvetësuar lëndën; sjellja e mirë dhe korrekte; respektimi i mendimeve; ndihma reciproke etj. Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet e tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet e tjera, siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet, janë të ndaluara.